



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.70/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie Morina-Ajvazi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Kujtim Bllaca nga Zvicëra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli Anr.70/2019. i datës 20.09.2019, e parashtruar nga Kujtim Bllaca, me të cilën kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Kujtim Bllaca, në të cilën pretendohet se i është refuzuar përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 20.09.2019 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) thekson se parashtruesi i ankesës ka dërguar aplikacionin për regjistrim pas afatit për regjistrim, me dt. 10 shtatorë 2019. Aplikacioni për regjistrim është dërguar në e-mail me dt. 18 shtatorë 2019, në orën 17:27.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimt, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Kujtim Bllacës është e pa rregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standartet e kërkuara sipas Rregullës Nr.02/2015 të nenit 11.5 ku përcaktohet se: Apelet të cilat janë të palejuara dhe të pasafatshme PZAP-i i Hudhë Poshtë me vendim.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në shqyrtimin e kësaj çështje, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 11.5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.2, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.5 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa

Anr. 70/2019 më datën 22.09.2019.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.